



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XIV-të (katërmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 19 shtator 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli kurse mungoi znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Xhevat Llughaliu nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës, z.Fadil Babatinca përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Podujevë, përfaqësues të KFOR, përfaqësues të OSBE.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroj punë të mbarë, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 24.07.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 24 korrik 2023

2. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024, me theks të veçantë, vijueshmëria e nxënësve të Komuniteteve jo shumicë, shqetësimet eventuale të tyre dhe pajisja me libra mësimore përfshirë edhe nxënësit e shkollave të mesme të larta.

z.Xhevat Llugaliu, shëf i sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit – DKA në Komunën e Podujevës, duke paraqitur Informatën në fjalë, theksoi, për shkak të angazhimeve drejtori i DKA nuk ka pasur mundësi të jetë prezent sot në këtë mbledhje. Viti i ri shkollor 2023/2024 ka filluar me kohë, pra më 1 shtator dhe atë në të gjitha institucionet edukativo arsimore të Komunës, përjashtimisht niveli 6/9 të shkollës fillore “Shaban Shala” që janë transferuar në objekt tjetër afër për 2 muaj për arsye se janë duke u bërë disa renovime në objektin e shkollës këtu afër Komunës. Të gjitha shkollat janë pajisur me ditarë, përjashtimisht niveli parashkollor nuk janë pajisur ende me ditarë për shkak apo fajin e operatorit ekonomik që nuk i ka sjellë ende, ndërsa për nivelet tjera janë siguruar ditarët.

Sa i përket qeshjes së furnizimit me libra, aq sa kemi njohuri ne do të kemi paksa problem, Ministria e Arsimit ka deklaruar se ne do i ofrojmë para se të fillojmë mësimin mirëpo pastaj kjo nuk është ofruar, për nxënësit e nivelit 1-5 shuma e parasë që do t’iu jepen është 60 euro, ndërsa niveli 6 deri 9 është 30 euro, Sa i përket furnizimit me tekste shkollore nxënësit e paraleles që u përmenden, DKA nuk ka buxhet për t’i furnizuar por jemi në përpjekje me donator që të sigurojmë mjete për furnizimin e nxënësve të komunitetit jo shumicë dhe nxënësve që janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale.

Kryesuesi i Komitetit, pyeti parafolësin se a posedon listë apo numër të nxënësve që janë regjistruar

z.Xhevat Llugaliu, shëf i sektorit në DKA, theksoi, nuk ka pasur kufizime, të gjithë janë regjistruar edhe në shkollën fillore edhe në shkollën e mesme, pastaj ka pas afat plotësues që ka qenë në muajin gusht sepse në afatin e parë nuk është plotësuar numri në tri shkollat e mesme, andaj edhe është hapur afati i gushtit, mirëpo tani nuk e kam numrin e sakt se sa nxënës janë regjistruar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, më konkretisht mua më interesoi ta di se a keni shënime lidhur me regjistrimin e nxënësve të klasës së parë.

z.Xhevat Llugaliu, shëf i sektorit në DKA, theksoi, unë e posedoj një listë të tillë dhe mund t’jua ofrojë ndërkohë ngase për momentin nuk i posedojë këtu, por mund të vish në zyrë dhe t’i marrësh të gjitha veq e veq për se cilën shkollë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se sot është dashur ta kemi një statistikë të tillë në mënyrë që ta shohim sa nxënës janë regjistruar dhe a ka mbetur ndonjë nxënës pa u regjistruar.

z.Xhevat Llugaliu, shëf i sektorit në DKA, theksoi, asnjë nxënës i nivelit në fjalë nuk ka mbet pa u regjistruar, madje këtë e kemi edhe obligim ligjor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë si Kryesues i këtij Komiteti dhe përfaqësues i tyre jam interesuar që nxënësit e klasës së I-rë, të regjistrohen. Në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.“Ali Ajeti” ku edhe unë jetojë janë regjistruar disa nxënës në klasën e I-rë edhe përkundër vështirësive sepse prindërit nuk i kanë regjistruar me kohë. Pra ka pasur ngecje dhe në afatin e dytë i kemi regjistruar edhe pse ka pasur ngecje siç e ceka, është dashur t’i regjistrojmë dhe kështu që prej shkollave nuk kemi pasur ndonjë vështirësi të madhe, pastaj është dashur t’i dërgojmë edhe nëpër klasa që t’jua gjejmë vendet sepse nuk është lehtë ngase klasat janë plotësuar me nxënës, mirëpo disi i kemi regjistruar dhe kemi bërë zgjidhje.

Gjithashtu ju informojë se në klasa të mesme i kemi për momentin 15 nxënës të regjistruar, pra të gjithë ata që kanë dashur janë regjistruar dhe nuk kemi pasur ndonjë vështirësi gjatë regjistrimit për çka i falënderojë drejtorët e shkollave të cilët na kanë mundësuar edhe pa kritere në disa raste, pra ku kanë dashtë të regjistrohen edhe janë regjistruar.

Sa i përket problemit me libra, për komunitetin jo shumicë ka qenë një sfidë e madhe në këtë vit, sepse mënyra e aplikimit ka qenë shumë delikate për arsye se nuk kanë ditë të përdorin internetin, është dashtë të bëjë një zyre në lagjen ku jetojnë dhe e kam ngarkuar kolegen znj.Shkurte Sejdiun në lagjen tjetër ngase po thajse asnjë nuk kanë ditë të aplikojnë, pastaj një pjesë e tyre kanë shkuar edhe tek Agim Hyseni që t'iu ndihmoi në aplikim, por edhe tek persona tjera të cilët kanë qenë në dijeni se si të qasen dhe të aplikojnë për mjete buxhetore të subvencionimit të librave.

Mjetet buxhetore diku janë lëshuar diku ende jo, kështu që po kemi vështirësi sepse edhe mësuesit po kërkojnë që gjithqysh t'i posedojnë librat nxënësit, por ende si kanë marrë mjetet dhe është një vështirësi sepse prindërit jetojnë me një ndihmë sociale dhe atë ndihmë e kanë marrë dhe e kanë shpenzuar, kështu që nxënësit janë mbetë pa libra derisa të dalin mjetet në llogaritë e tyre. Pra po e përsërisë se në këtë çështje kemi vështirësi bukur të madhe sa që në një rast i është thënë një nxënësi që do ta largoj nga klasa deri por pastaj kemi intervenuar duke i'ua bërë me dije se nuk mund ta largosh prej klase për këtë arsye, edhe ky problem është zgjedhur.

Tani në lagjen tjetër që është në rr.“Xhafer Meta” kemi disa nxënës pa regjistruar dhe po u informova, nuk e kam ditur që nuk janë regjistruar ata nxënës edhe për vështirësitë e tyre që kanë sepse nuk më kanë informuar askush e që ndoshta është dashur të më informoj znj.Shkurte Sejdiu në mënyrë që të kem mundësi të intervenoj aty ku kjo nuk ka pasur mundësi.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, kemi 3 nxënës të peregjistruar, ku dy prej tyre janë për klasën e I-rë dhe një për parashkollor. Te rasti i nxënëses me emrin Agnesa nuk e di se si të shpjegojë, babai i saj është në burg kurse nëna e saj nuk është në shtëpi, ndërsa për të kujdesen gjyshërit e saj, por që nuk po mundën të aplikojnë për mjete të subvencioneve për libra sepse nuk kanë mund të regjistrohen as në shkollë. Rast të njëjtë kemi edhe me një tjetër ku po ashtu është e ngjashme sepse prindërit janë shkurorëzuar dhe fëmija u mbetë anash dhe nuk ka pasur mundësi të regjistrohet në shkollë. Ndërsa për rastin Emin Behluli është një fëmijë i cili e ka arritë moshën 11 vjeçare dhe unë personalisht nuk e kam ditur që ai është i peregjistruar dhe tani nuk më këtë rast nuk e di se si të veprojë. Ndërsa për Jasin Halili e ka kohën për parashkollor, por kur e kam vizituar unë ai më ka thënë se kur jam shkuar në shkollë më kanë thënë që je për klasë të parë dhe nuk po tregojnë për cilat arsye nuk është regjistruar, për çështje ekonomike apo çështje tjera.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra Emin Behluli nuk është regjistruar ende, ndërsa për të tjerët nuk ka qenë problemi që nuk kanë pasur kujdestari dhe nuk kanë mund të regjistrohen sepse vetëm me një certifikatë kanë mund të regjistrohen.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, sa jam e njoftuar, te rasti i Agnesës duhet prindi ose kujdestari i saj ligjor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nuk ka nevojë me qenë prindi apo kujdestari, atë mund ta regjistrojë dikush tjetër, vëllai, motra apo ndokush që i afërm. Unë këtë nuk e kam ditur por nga sot do të merrem me të.

Për nxënësit e klasës së mesme kemi bërë kërkesë në DKA-së, në qoftë se ka mundësi Komuna të sigurojë tekstet shkollore ngase nga paslufta e deri tani Komuna e Podujevës ka bërë furnizimin me libra të shkollave të mesme, ngase për nxënësit e shkollave fillore e dim që librat janë siguruar në shkollë, kështu që e kam bërë një kërkesë dhe ende nuk kam marrë përgjigje se a do të sigurohen tekstet shkollore apo jo për nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe jo vetëm që ndjekin mësimin e mesëm.

z.Xhevat Llugaliu, shëf i sektorit në DKA, theksoi, lidhur me kërkesën për tekste shkollore, jam informuar nga drejtori i DKA-së se nuk kemi kod të caktuar për të bërë furnizimin e të gjithë nxënësve të komunitetit jo shumicë dhe atyre me gjendje të rëndë sociale, por jemi në përpjekje që të gjejmë një donator për furnizimin e tyre.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, i falënderojë të gjithë të pranishmit, dihet që shkolla është shtylla kryesore dhe një ndër themeloret e të drejtave të njeriut, dhe në këtë kontekst unë dëgjova me vëmendje por i kam edhe shqetësimet e mia që ne si shoqëri dhe si institucione nga nivelet lokale dhe ato qendrore duhet të angazhohemi dhe të bëjmë më shumë për çështjet e grupeve të cenueshme apo të marginalizuara nëse mund t'i quaj kështu, me theks të veçantë për komunitetin jo shumicë, duke qenë në dijeni për gjendjen reale dhe faktike siç janë gjendja e rëndë socio-ekonomike, papunësia, varfëria dhe shumë elemente tjera të ngjashme, dhe për këtë mendoj se arsyeja është shumë e thjeshtë, të futen mekanizmat e që secili institucion i ka mekanizmat e vet, pra DKA i ka mekanizmat e vet që të merret edhe me këtë fushë dhe të ketë një pasqyrë për të gjithë nxënësit e sidomos atyre të komuniteteve jo shumicë rreth asaj që nuk e vijojnë procesin mësimor, e që dihet që mësimi në shkollat fillore është obligativ, nga fillimi parashkollor e sidomos nga klasa e I-rë deri në të klasën e IX.

Jam shumë i shqetësuar dhe i vetëdijshëm dhe kam informacione më herët që në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.“Xhafer Meta” është familja Behluli që numerikisht janë familje e madhe 63 anëtarë dhe normale që për shkaqe ekonomike sociale dhe shumë tjera që ndoshta nuk e kan ngritur atë nivelin e vetëdijës rreth rëndësisë së shkollimit dhe mungesës së regjistrimit me kohë, prandaj ndoshta është edhe kjo si pasqyrë e asaj që ka ardhur që në moshën 11 vjeçare tash të hyjë në klasë të I-rë, ku në moshën 11 vjeçare duhet me qenë diku në klasën e 5 ndoshta dhe aty normale që duhet të jetë një koordinim i mirë edhe i prindërve me shkollë, ndoshta kjo është ajo që mekanizmat të jetë funksional, si DKA, si drejtori i shkollës dhe si këshill i prindërve.

Këshilli i prindërve normale që nuk e din gjendjen reale në teren në lidhje me atë që e theksoi edhe kryesuesi, që të jemi edhe ne si trup në këtë Komitet për Komunitete dhe njëkohësisht edhe ZKKK të kemi informacione më të sakta, për arsye që pse nuk kan shkuar në shkollë. DKA nuk mund të del në terren dhe të dijë sakt përse ata nxënës nuk kan filluar shkollimin, por DKA mund ta dijë që përse e ka braktisë shkollimin dhe jo pse nuk e ka filluar shkollimin, në këtë aspekt DKA nuk mund të jap përgjigje për shkaqet që ata nuk e kan braktisur shkollimin por nuk kan filluar me procesin e mësimorit. Në qoftë se e kan braktisur shkollimin atëherë duhet të jemi përgjegjës të gjithë dhe kjo është ajo që ne duhet të angazhohemi që edhe këta nxënës të kthehen në procesin mësimor, pra të bisedohet edhe nga ne si ZKKK dhe nga Kryesuesi i Komitetit me ato familje që nuk i kan regjistruar me kohë fëmijët në shkollë dhe të bëjmë tentativat tona që ata të kthehen në bankat shkollore.

Arsyeja tjetër është që e përmendi shëfi i Sektorit të Arsimit z.Xhevat Llugaliu që kësaj radhe ka qenë më problematike sa i përket teksteve shkollore, ne e dim që në të kaluarën tekstet shkollore kan qenë normale në mënyrë tjera, tani është qeshja e rimbursimit, mirëpo ka raste ku edhe u cekën që nuk kan ditë t'i plotësojnë aplikacionet dhe normale që kan ngecë në atë aspekt, pastaj edhe afatet kanë qenë problematike sepse disa kanë aplikuar më herët dhe është një numër i tyre që tani duhet të aplikojnë dhe t'i plotësojnë ato.

Unë e kam një shqetësim që lidhet me një person i cili erdhi tek unë, e që në disa raste është problematike të gjejmë forma dhe mënyra se qysh të vim deri tek ndihma e atyre nxënësve, pra shembull e kam një rast në fshatin Batllavë, janë një familje me 8 anëtarë ku nëna ju ka vdekur dhe shtesat e fëmijëve kanë problem t'i marrin sepse jemi në dijeni se është dashtë të aplikohet përmes nënës, ashtu besoj edhe për t'i fituar mjetet për tekste shkollore, babai i tyre është martuar dhe nuk

jeton me atë familje, normal fëmija më i rritur është në moshën 21 vjeçare dhe kujdeset për të tjerët, mandej ka një motër dhe një vëlla, ku motra Leotrina është në klasën VIII-të dhe vëllai Leotrimi në klasën e V-të, dhe më pyetën për këtë problematik e normale që duhet të gjendet një formë se si mund t'ia sigurojmë tekstet shkollore kur janë të papunë dhe me gjendje të rëndë ekonomike ku nuk kanë asnjë burim tjetër, por me ato mundësi që ka tani në rolin e prindërit.

Ky është vetëm ndoshta një prej rasteve sepse po të hulumtojmë mund të gjejmë edhe shumë raste tjera të ngjashme, mirëpo çështja është se janë njerëz dhe jetojnë me gjendje të rëndë ekonomike, po e them këtë duke pas parasysh që ka edhe nga komuniteti shumicë raste të tilla.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, një problem si që e tha edhe z.Liman Zeqiri e kemi te lagja ku jetojnë familje të komunitetit jo shumicë në rr.“Xhafer Meta” ku i ka vdekur babai një fëmiju dhe nëna ju ka martuar dhe ka shkuar në Gjermani kurse ai fëmijë ka mbet me gjyshen e vet e i cili nuk mund t'i marrë shtesat, dhe më keqja është se nuk mund të regjistrohet për rimbursim të librave, kështu që ne pas përpjekjeve që ta zgjidhim këtë problem, kemi vendosur si lagje që në qoftë se ai fëmijë regjistrohet do t'ia blejmë librat sepse për ndryshe ai nuk mund t'i merr librat, pra ky është vetëm njëri prej shqetësimeve. Ndërsa shqetësimi tjetër është ku edhe nxënësit e klasës së I-rë që nuk i kanë mbushur 6 vjet nuk po kanë mundësi të rimbursohen sepse sistemi nuk po i pranon dhe ata kanë mbetur ashtu pa libra. Pra kemi rreth 5-6 persona të cilët nuk po mund t'ia sigurojnë rimbursimet e teksteve shkollore por jemi në kontakt me familjet e tyre që t'iu bëjmë zgjidhje sa i përket aplikimit dhe çështjeve tjera të nevojshme.

Kjo është një shqetësim bukur i madhe sepse janë me ndihma sociale nga të cilat pothuajse edhe jetojnë kurse tani nuk kanë mundësi t'ia blejnë, çështje e cila është shumë shqetësuese dhe nuk po dim as ne se si të veprojmë për këta nxënës të klasës së I-rë të cilët nuk i kanë mbushur 6 vjet, por duhet të konsultohemi në lidhje me ndonjë akt ligjor apo nënligjor në bazë të të cilit mund të jetë e rregulluar kjo çështje që nxënësit të cilët i kanë mbushë 6 vite për t'ia marrë librat.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, në mbledhjen e ardhshme kërkoj nga ju si përfaqësues i komuniteteve jo shumicë, që pikë të rendit të ditës të jetë të jetë çështja se deri ku ka shkuar ky proces i regjistrimit të fëmijëve të komuniteteve jo shumicë. Gjithashtu kërkojmë nga ju që deri në mbledhjen e ardhshme të kontaktoni me DKA dhe të gjendet një zgjidhje për këto raste.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konstatoi të përfunduar dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Të Ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, është një rast i cili kërkohet të paraqitet i cili më është drejtuar mua, fjala është Rashit Sejdiu i cili banon në rr.“Xhafer Meta” dhe të cilit gjatë punimeve në rrugën afër shtëpisë së tij i është qarë shtëpia. Ai person ka qenë 5-6 herë në Komunë për ta paraqitur këtë rast por që ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje, madje në një rast kamë qenë edhe unë me të, edhe pse i është thënë që do t'ia kompensojmë dëmtimet, por nuk kanë ndërmarr asgjë deri tani, prandaj ai vazhdimisht e shpreh këtë shqetësim dhe sot më tha se nuk po di ku të drejtohem më. Ne si komitet dhe si komunitete nuk po dimë se si të veprojmë në lidhje me këtë rast për të cilin është i informuar edhe z.Liman Zeqiri shef i ZKKK, pra zgjidhje nuk ka ende për këtë rast.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të mbajtur më 15.08.2023, ka qenë një pikë ku ka pas interesim jashtëzakonisht të veçantë me theks për të gjithë qytetarët por edhe për Komunitetet jo shumicë sa i përket infrastrukturës dhe projekteve ku ka pas një diskutim të hapur e që prezent ishin edhe Kryetari i Komunës dhe drejtorët e disa drejtorive relevante, ndër të tjera është diskutuar edhe mundësia e shqyrtimit të kërkesave të ndryshme ku është thënë se mundësisht deri në muajin shtator kur del për shyrtim dhe miratim buxheti i Komunës për vitin e ardhshëm të sjellën kërkesat apo projektet e nevojshme, nuk kam njohuri se a ka shkuar apo jo ndonjë projekt i tillë konkret që prekë qytetarët me theks ata të komuniteteve jo shumicë.

Unë për hir të asaj që e kam parë, është një projekt i rëndësishëm që e kam dorëzuar me shkrim te Kryetari i Komunës dhe mendojë që ai ka kaluar te Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Fjala është për projektin e rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.“Ali Ajeti” projekt i cili dihet se ka qenë i hartuar para 1 viti dhe ka hyrë në planifikime për realizim por që nuk ka mundur të hyjë për shkak se ky plan që e kem dërguar me 18 gusht 2022 në Zyrën për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit, por që proceduar kanë ngecur edhe pse është thënë që do të kalojë. Jemi në dijeni se lagjia në fjalë ka mbetur keq në këtë aspekt mirëpo tani mendoj se tani Komuna e Podujevës dhe Kryetari i Komunës do t’i përdorë edhe mekanizmat tjerë në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal me të cilët ka kontaktuar në funksion të gjetjes së një forme dhe mundësie për realizimin e projektit në fjalë si një prej projekteve më të rëndësishme tani për tani për ata banorë të komuniteteve jo shumicë dhe jo vetëm

Pra deshta të them që diskutimi ka qenë i hapur në aspektin e sjelljes së projekteve nga përfaqësuesit e lagjeve në mënyrë që pastaj të futen në sistemin buxhetor, prandaj kur kemi këto thirrje publike është mirë të sjellën me shkrim kërkesat dhe projekte të tilla nga të gjithë në mënyrë që pastaj të përfshihen në sistemin buxhetore për realizimin e tyre.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për sqarimet e dhëna, vërtetë projekti që përmendi zotëri Zeqiri është projekt që po pritët me kohë sepse e dim që uji në lagjen e cekur ku jetojë edhe unë, sipas disa analizave që i janë bërë, është i papërdorshëm, por disa e përdorin sepse nuk kan zgjedhje tjera, lutem që të kryhet sa ma shpejt ky projekt.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti,
Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-060/04-0071607/23
Podujevë, 19 shtator 2023**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**